



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

Nr. 1062 Prot

Fier, me 19.09.2025

**PROJEKT VENDIM**

Nr. 82, Datë 19.09.2025

**“Për një ndryshim në VKB nr. 139, datë 23.12.2024, ‘Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025–2027, të buxhetit dhe të numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Fier për vitin 2025’, i ndryshuar, si pasojë e ristrukturimit të administratës dhe të institucioneve vartëse të Bashkisë.”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, neni 9, pika 1.1, shkronja “b”, neni 54 -dh), n) ; neni 55 pika 3 të Ligjit nr 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ; Ligjin nr.68 datë. 27.04. 2017 “Per Financat e Veteqeverisjes Vendore”; Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (I ndryshuar); Ligjin nr. 152/2013, “ Për statusin e Sherbimit Civil ” i ndryshuar ; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.139 datë 23.12.2024 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm PBA (2025-2027), dhe miratimin e buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2025”, i ndryshuar, në kërkesat e paraqitura nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore Shërbimit dhe Inovacionit teknologjik me shkresën nr. 10344 prot dt 15.09.2025 ; nga Drejtoria Financë Buxhet dhe Kontabilitet me shkresën nr. 9626 prot dt 25.08.2025 ; Drejtoria Juridike dhe e Hartimit të Kontratave me shkresën nr. 10436 prot dt 16.09.2025, ka paraqitur kërkesën për shtesë të numrit të punonjësve. Drejtoria e Hartimit të Politikave & Kontrollit për Taksat dhe Tarifat Vendore, me nr. 10343 prot dt 15.09.2025; Drejtoria e Artit Kulturës Turizmit dhe Promovimit në Teatrin Bylis, me shkresën nr. Prot dt 789 prot dt 30.12.2024; Qendra Ekonomike e Arsimit, me shkresën nr. 603 prot dt 12.09.2025; Drejtoria e Hartimit të Projekteve të Infrastrukturës me shkresën nr. 10338 prot dt 15.09.2025; Drejtoria e Shërbimit Social me shkresën nr. 10304 prot dt 12.09.2025; Shtëpia e të Moshuarve me shkresën nr. 45 prot dt 12.09.2025, Drejtoria e Prokurimeve Monitorimit dhe zabtimit të kontratave me shkresën nr. 10335 prot dt 15.09.2025; Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Sistemit të Adresave, e Transportit publik dhe Sinjalistikës rrugore, me shkresën nr. 10336 prot dt 15.09.2025; Drejtoria e Mardhënieve me Publikun dhe Arkiv Protokollin me shkresën me nr. 10303 prot dt 12.09.2025; Drejtoria e Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Monitorimit të Procesit të Legalizimeve me shkresën nr. 10295 prot dt 12.09.2025; Drejtoria e Menaxhimitt ë Pronave me shkresën nr. 10301 prot dt 12.09.2025; Drejtoria e Ndjekjes së Kundravajtjeve Administrative dhe Policisë Bashkiake, nr. 658 prot dt 16.01.2025; Drejtoria e Mbrojtjes Civile Bashkia Fier, me shkresën nr. 10315 prot dt 12.09.2025; Drejtoria e MZSH-së, nr. 270 prot dt 23.12.2024, dhe me shkresën nr. 122 prot dt 10.06.2025; Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, me shkresën nr. 438 prot dt 28.05.2025 si dhe me shkresën nr. 757 prot dt 12.09.2025; Ndërmarrja e Shërbimeve të Pastrimit me shkresën me nr. 305 prot dt 27.05.2025, dhe shkresën nr. 586 prot dt 12.09.2025; Ndërmarrja e Ujitjes dhe Kullimit me shkresën me nr. 71 prot dt 19.02.2025, shkresën nr. 279 prot dt 09.06.2025,

dhe shkresën nr. 475 prot dt 12.09.2025; Ndërmarrja e Shërbimeve të Gjelbërimit Higjenës dhe Mirëmbajtjes së Varrezave Publike me shkresën nr. 729 prot dt 03.06.2025, si dhe bazuar ne qellimet dhe objektivat e Bashkise Fier.,

### **PROPOZOJMË:**

1. Të shtohet numri i përgjithshëm i punonjësve të Bashkisë Fier për vitin 2025, nga 1,570 punonjës në 1,658 punonjës.
2. Efektet financiare do të mbulohen nga fondi rezervë i miratuar në buxhetin e Bashkisë Fier për vitin 2025.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Fier.

**Për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore**

Drejtori Rozëta Memo

**Për Drejtorinë Juridike**

Drejtori Esmeralda Kapllanaj

**Për Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit**

Drejtori Pranvera Cina

**KRYETARI**

**Armando Subashi**

